



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA**

Datë: 09.06.2025
Numër Protokolli: 3923/2025

A.nr.803/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Eshref Shabani dhe Malsore Gashi, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar në çështjen juridike administrative sipas ankesës me numër A.nr.803/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H., kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në çështjen juridike *‘Kontestim konkursi’*, në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.06.2025, mori këtë.

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.803/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, G.H.(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 02.05.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është regjistruar më datë 05.05.2025 me numër protokolli 2942/2025, nën shenjën A.nr.803/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016976, për pozitën e punës Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve, të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, vendosi për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.803/2025, të datës 05.05.2025, pasi që nga kërkesa e datës 09.06.2025 e parashtruar përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, rezulton se ankuesi nuk ka interes juridik që të vazhdoj me këtë procedurë administrative.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.803/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.H.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.